**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E MITROVICËS-OPŠTINA MITROVICA
02 Nr.Prot./Br.Prot. 02-060/01-0069482-4/24
Nr i Inf./Br.ul.
Data/Datum 30.10.2024
Mitrovicë - Mitrovica

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**
**Nr. 02-060/01-0069482-4/24 dt. 30.10.2024**
**Mitrovicë**

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, pika d, dhe nenit 17, paragrafi 1, pika k, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008); nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe nenit 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.11 të Statutit të Komunës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 30.10.2024, pasi shqyrtoi Kërkesën e DMS-së Nr. 02-352/05-0067249/24 dt. 09.10.2024 Për vazhdimin e marrëveshjes me Këshillin e Bashkësisë Islame – Dega në Mitrovicë për ofrimin e shërbimeve të varrimit për qytetarët e Komunës, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0067951-4/24 dt. 23.10.2024); sjell këtë:

# VENDIM
## Për autorizim të Kryetarit Komunës për rinegociim dhe arritje të Marrëveshjes me Këshillin e Bashkësisë Islame – Dega në Mitrovicë

1. AUTORIZOHET Kryetari i Komunës të rinegociojë dhe të arrijë Marrëveshje me Këshillin e Bashkësisë Islame – Dega në Mitrovicë për vazhdimin e Marrëveshjes Për kryerjen e shërbimeve dhe ceremonive fetare si edhe ekzaminimin e kufomës duke inkuadruar edhe mjekun nga QKMF-ja.
2. Sipas pikës 1 të këtij Autorizimi, Kuvendi i Komunës e obligon Kryetarin që të negociojë çmimin e ofertës së specifikuar të Këshillit të Bashkësisë Islame – Dega në Mitrovicë
3. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

**Mitrovicë**

**Kryesuesja e Kuvendit**
Broja
**Vesa BROJA**

**Dorëzohet:**
**1 x 1** **Kryesueses së Kuvendit**
**1 x 1** **MAPL-së**
**1 x 1** **Arkivit**
**Kopje:** **Kryetarit të Komunës**
**Drejtorisë për mirëqenie sociale**